

## **Të nderuar Tatimpagues!**

**Njoftim për ndryshim të pages minimale dhe maksimale për efekt të pageses së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe për menyren e deklarimit për muajt korrik dhe gusht 2011.**

Në zbatim të pikës 1, të Vendimit Nr.541, datë 27.07.2011 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr.1114, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nr.9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.7870, datë 13.10.1994, “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, **pagesa minimale mujore**, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve, shoqërore e shëndetësore, **nga data 1.7.2011** e në vazhdim, të jetë **jo më pak se 17.540** (shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë, ndërsa **pagesa maksimale mujore të jetë 87.700** (tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) lekë.

*Me qëllim që të shmangët penalizimi me gjoja dhe interesa për pagesë të vonuar të detyrimeve shtesë për kontributet dhe TAP, që rezultojnë nga rillogaritja e pagave në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.541, datë 27.7.2011, subjektet e regjistruara në biznesin e madh, të cilat kanë deklaruar dhe paguar detyrimet e periudhës tatimore korrik 2011, diferencat e pagave të periudhës tatimore korrik t'i bashkojnë me pagat e periudhës tatimore gusht dhe t'i deklarojnë në deklaratën e periudhës tatimore gusht 2011. Listëpagesa e periudhës tatimore gusht 2011 të përmbajë vetëm pagat e muajit gusht.*

*Për periudhën tatimore korrik 2011, me deklarimin e muajit gusht, subjektet të dorëzojnë një listëpagesë të ndryshuar, e cila të përmbajë pagat e plota për muajin korrik sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.541, datë 27.7.2011.*

*Kjo listëpagesë e ndryshuar do të zvendësojë listëpagesën e muajit korrik me pagat e pandryshuara, të dorëzuar në organin tatimor, dhe do të jetë listëpagesa përfundimtare për periudhën tatimore korrik 2011, e cila do të administrohet si e tillë.*

Ky vendim i shtrin efektet financiare **nga data 01 Korrik 2011**. Pra zbatimi i vendimit fillon me pagat e periudhës tatimore **Korrik 2011** e në vijim.

**Administrata tatimore ju mirëpret!**